

VENDIM
Nr.1291, datë 23.12.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS ÇAKRAN TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Çakran të qarkut të Fierit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Çakran të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.357, datë 27.3.2008 të Këshillit të Ministrave ”Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Çakran të qarkut të Fierit ”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Çakran për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Çakran

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
7	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
8-27	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
28-37	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
38-51	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
52-119	Varrezat publike	Në pronësi
153,158,163,167,173,178,181, 182,186,188,189,196,201,204, 212,215,216,219,221,222,224, 226,230,235	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
211,213,214,217,218,220,223, 225,227-229,231-234,236	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
241-269	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi

